



REPUBLIKA E KOSOVËS		REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS		VRHOVNI SUD KOSOVA
G.J.A-Su.A	381 2023	
Dt:	27. 02. 2023	
PRISHTINË - PRIŠTINA		

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO**

---

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në Seancën e Përgjithshme të gjithë gjyqtarëve, në bazë të nenit 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. dhe nenit 27, paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 06/L -054, i datës 23 nëntor 2018), më datën 27 shkurt 2023, me shumicë votash aprovoi këtë:

**UDHËZUES JURIDIK**

Ligji i aplikueshëm: Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.04/L-034, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/datë 21 shtator 2011.

I. Nga data e parashtrimit të Njoftimit të Vendimit për Likuidim, e deri në përfundimin e likuidimit, PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përbartimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.

II. Pezullimi i procedurave të lartpërmendura nuk aplikohet në:

- Veprimet gjyqësore që në emër të ndërmarrjes drejtohen kundër palëve të treta;
- Procedurat penale ndaj ndërmarrjes apo një apo më shumë anëtarëve të Menaxhmentit të saj;
- Transferimet apo disponimi me asetet e ndërmarrjes gjatë rrjedhës së rregullt të punës së ndërmarrjes, përfshirë transaksionet e përcaktuara në këtë Ligj dhe në veçanti në nenin 10;
- Procedurat apo veprimet rregullative që kanë të bëjnë me parandalimin apo korrigimin e shkeljeve të dispozitiveve rregullative, rregullave apo vendimeve, nëse ato nuk përfshijnë pretendime monetare ndaj ndërmarrjes; dhe

-Inspektimet dhe kërkesat për inspektim të parashtruara nga bartësit e hipotekave të regjistruara, garancive të vërteta apo pengjeve të ngjashme që kanë të bëjnë me asetet e ndërmarrjes.

III. Procedurat e pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhoma e Posacme apo nga Autoriteti i Likuidimit.

### A r s y e t i m i

Gjykata Supreme e Kosovës, në praktikën e saj ka konstatuar praktikë jo unike lidhur me çështjen se a duhet pezulluar procedura përbëimore kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i vendimit për likuidim, lidhur me kërkesat monetare, apo duhet vazhduar procedura gjyqësore përbëimore lidhur me kërkesat e tillë monetare, pavarësisht që ndërmarrja kundër të cilës zhvillohet kjo procedurë gjyqësore përbëimore ndodhet në procedurë të likuidimit. Kjo praktikë jo unike e gjykatave të instancës më të ulët kryesisht ka të bëjë me ligjin e aplikueshëm dhe vendimmarrjen e ndryshme në rastin e realizimit të kërkesës monetare të kreditorit ndaj debitorit i cili është në procedurë të likuidimit.

Gjykata Supreme e Kosovës, nga praktika e saj, por edhe nga kërkesa e Agjencisë Kosovare të Privatizimit/Autoriteti i Likuidimit/ e datës 13 shtator 2022, për dhënie të qëndrimit të saj lidhur me çështjen e sipërpërmendur, e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e kësaj çështjeje përmes një udhëzuesi juridik, nxjerra e të cilit do t'i kontribuojë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjet e tillë, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në gjykata.

Juridikioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë udhëzues juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat. Me nenin 27 të këtij ligji, përcaktohet se Seanca e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka të drejtë të nxjerrë udhëzues juridik, qëndrime parimore dhe mendime juridike me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes

një udhëzuesi juridik ka rrjedhur si propozim dhe konkludim i kësaj gjykate, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të disa vendimeve gjyqësore për çshtjet e tillë si në rastin konkret, si dhe të kërkesave për dhënie të këtij udhëzuesi juridik.

Objekt i këtij udhëzuesi juridik, pra është udhëzuesi për gjykatat e instancës më të ulët se si duhet vepruar me rastin e kërkesës/propozimit përmbarim në vlerë monetare, të kreditorit ndaj debitorit i cili ndodhet në procedurë likuidimi, më saktësisht realizimi i kërkesës së tillë a duhet bërë në procedurë përmbarimore, pavarësisht se i njëjti debitor ndodhet në procedurë të likuidimit, apo duhet pezulluar kjo procedurë përmbarimi deri në vazhdimin e saj me miratimin për vazhdim nga ana e Dhomës së Posaçme apo Autoritetit të Likuidimit.

Në këtë kontekst, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se nen 10 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit Nr. 04/L-034, për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, përcakton që: “*Çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që përfshin apo që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i Vendimit për Likuidim pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të Vendimit për Likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet këtij nen 10 dhe shoqërohet me një kopje të Vendimit për Likuidim dhe një kopje të Njoftimit të publikuar për likuidim*”. Nga kjo rezulton se me këtë dispozitë të këtij ligji të posaçëm, rregullohet në mënyrë specifike çështja e pezullimit të veprimeve ndaj ndërmarrjeve shoqërore në likuidim si dhe në mënyrë të qartë është e rregulluar çështja e shpërndarjes apo ekzekutimeve të vendimeve të autoritetit të likuidimit apo vendimeve të formës së prerë të gjykatës (në rastet kur aprovojen kërkesat kreditore apo kur aprovojen ankesat/paditë e kreditorëve në gjykatë).

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme, lidhur me këtë çështje ka nxjerrë Udhëzues Juridik C-IV-15-1607, të datës 15 tetor 2015, i cili ka paraparë se:

*“I.Nga data e parashtrimit te Njoftimit te Vendimit per Likuidim, e deri në përfundimin e Likuidimit PEZULLOHET çdo procedurë gjyqësore, administrative apo e arbitrazhit që është kundër ndërmarrjes dhe aseteve të saj që është subjekt i Vendimit për Likuidim, përfshirë edhe procedurat përmbarimore të vendimeve të formës së prerë lidhur me kërkesat monetare.*

*II. Pezullimi i procedurave nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3 te nenit 10 të Shtojcës së Ligjit (nr. 04/L-034) per AKP-në.*

*III. Procedurat e pezulluara mund të lejohen të vazhdojnë vetëm me miratimin e kërkesës nga Dhomë e Posacme”.*

Përmes këtij udhëzuesi juridik Gjykata Supreme e Kosovës konfirmon qëndrimin që është marrë në Udhëzuesin juridik të Dhomës së Posacme, nga se me nenin 31 parografi 1, të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit nr.04/L-034, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.19/datë 21 shtator 2011, parashihet që *ky Ligj mbisundon çdo dispozitë tjetër që është në kundërshtim me të*, dhe si rrjedhojë, rezulton se në pajtim me nenin 10, të Shtojcës së këtij Ligji, çdo veprim gjyqësor, administrativ apo i arbitrazhit, procedurë apo akt që është kundër një ndërmarrje (apo aseteve të saj) që është subjekt i vendimit për likuidim, pezullohet pas parashtrimit të njoftimit të vendimit për likuidim nga ana e Autoritetit të Likuidimit në gjykatën përkatëse, autoritetin publik, apo tribunalin e arbitrazhit. Ky njoftim i referohet nenit 10, të këtij ligji dhe shoqërohet me një kopje të vendimit për likuidim dhe një kopje të njoftimit të publikuar për likuidim. Veprimet, procedurat apo aktet e tillë të pezulluara mund të vazhdojnë apo të jenë në fuqi vetëm me leje të autoritetit të likuidimit apo të gjykatës.

Pezullimi i veprimeve, procedurave dhe akteve nuk aplikohet në rastet e parapara me paragrafin 3.1; 3.2; 3.3; 3.4; dhe 3.5; të nenit 10 të Shtojcës së këtij Ligji (nr. 04/L-034) për AKP-në, të përmendura më afér në pikën II, të këtij Udhëzimi Juridik.

Si përfundim Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këto raste organet kompetente duhet të pezullojnë çdo veprim gjyqësor, administrativ apo të arbitrazhit, procedurë apo akt që është kundër një ndërmarrjeje (apo aseteve të saj) që është subjekt i vendimit për likuidim, detyrim ky që buron nga neni 10 i Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit e cila dispozitë ligjore ka epërsi në zbatim referuar nenit 31 të këtij ligji ndaj çdo dispozite të ndonjë ligji tjetër.

*Udhëzues i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur me datë 27 shkurt 2023)*